

Titulli i lëndës: **E drejta e medias**

Informatat themelore për lëndën		
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë – Departamenti i Gazetarisë	
Titulli i lëndës:	Ligji dhe mediat	
Niveli:	Bachelor	
Statusi i lëndës:	Obligative	
Viti i studimeve:	Viti i III-rë, semestri i VI-të	
Numri i orëve në javë:	2 + 2	
Kreditë ECTS:	4	
Koha / Vendi:		
Mësimdhënësi:	Prof.Asst.Dr. Faton Ismajli, /	
Të dhënat kontaktuese:	faton.ismajli@uni-pr.edu	
Përshkrimi i lëndës:	Në këtë lëndë studentët mësojnë, diskutojnë dhe studiojnë teorinë dhe praktikën e ligjeve që rregullojnë fushën e mediave, duke filluar prej koncepteve bazë të lirisë së mendimit, lirisë së shprehjes, lirisë së mediave që janë të drejta themelore të njeriut. Përmes ligjëratave dhe diskutimeve studentët njoftohen për rregullimin ligjor vendor e ndërkombëtar të fushës së medias, për përgjegjësitë e gazetarëve, për përgjegjësitë e mediave, për interesin publik, për privatësinë, për të drejtën për t'u harruar, për raportimin nga gjykata, për rregullimin ligjor të ruajtjes së burimeve, për raportimin nga gjykatat, për të drejtën për t'u harruar si dhe për politikat redaktoriale të mediave	
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ka për qëllim ti ofroj studentëve me një kuptueshmëri të gjerë dhe kritike të ndërtimit dhe funksionimit të elementeve të sistemit legal të funksionimit të mediave si dhe të sigurojë që ata kanë kuptueshmëri themelore të natyrës dhe metodave të ligjit dhe studim akademik ligjor. Kjo lëndë paraqitet tek studentët në perspektivat e më poshtme: - Perspektiva institucionale: kornizën e institucioneve ligjore siç janë ndërtimi dhe organizimi i shteteve - Perspektiva metodologjike: Metodot ligjore dhe arsyetimet ligjore siç janë burimet e ligjit dhe interpretimi i ligjit dhe - Perspektiva teorike: Kuptueshmëria e ligjit siç janë natyra dhe funksionimi i ligjit, rregullat ligjore dhe sistemi ligjor ne raport me mediat. - Të kuptuarit për politikat mediale	

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studenti pritët të jetë në gjendje që:

Të kuptojë dhe të shpjegojë konceptet themelore ligjore që lidhen me lirinë e medias, përgjegjësinë ligjore dhe të drejtat e profesionistëve të medias në kontekstin vendor dhe ndërkombëtar.

Të identifikojë dallimet ndërmjet kuadrit kushtetues, ligjor dhe etik që rregullon fushën e mediave në një shoqëri demokratike.

Të analizojë rregullimin ligjor të fushës së medias në Kosovë dhe ta krahasojë atë me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Të dallojë në praktikë situatat ku ka shkelje të ligjit nga mediat ose ndaj mediave, duke iu referuar normave të sanksionuara ligjërisht.

Të kuptojë dhe të aplikojë konceptin e lirisë së shprehjes në raport me kufizimet ligjore të saj, siç janë shpifja, fyerja, mbrojtja e privatësisë dhe urrejtja në diskursin publik.

Të vlerësojë përgjegjësinë e gazetarëve dhe institucioneve mediale në përputhje me parimet e së drejtës, veçanërisht kur raportohet për institucione të drejtësisë ose çështje të ndjeshme publike.

Të analizojë çështje konkrete ligjore që lidhen me raportimin nga gjykatat, mbrojtjen e burimeve, të drejtën për t'u harruar, dhe të drejtën e autorit, duke ndërtuar argumente të bazuara në normat juridike.

Të zbatojë njohuritë e fituara në analiza praktike të vendimeve gjyqësore, rregulloreve apo rasteve nga praktika mediale, në mënyrë të pavarur dhe kritike.

Të reflektojë në mënyrë etike dhe ligjore mbi ndikimin e mediave online dhe rrjeteve sociale, veçanërisht në kontekstin e gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Të zhvillojë aftësi për të interpretuar dhe aplikuar norma juridike që lidhen me punën mediale dhe komunikimin publik, duke demonstruar kompetencë teorike dhe praktike në trajtimin e çështjeve ligjore.

1.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	20 min	15	5
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	0.5	15	7.5

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	1	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1	5
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			121.5 orë= 4 ECTS (121.5:25=4.86)
Metodat e mësimdhënies:	-ligjërata -test -ushtrime - Seminar		
Metodat e vlerësimit:	Testi gjysmësemestral (Java e shtatë) – 20 pikë Detyrat e shtëpisë – 20 pikë Pjesëmarrja aktive në klasë - 10 Seminari - 20 Vlerësimi i fundit (provimi): 1-30 pikë. Totali: 100 pikë +. Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese. Provimi: 1. Mbas javës së shtatë mbahet testi i parë i vlerësimit të njohurive të studentëve. 2. Pas ligjëratave studentët marrin gjithnjë detyra të cilat obligohen t'i ushtrojnë në shtëpi dhe në orën e ushtrimeve; pikët e fituara numërohen në notën përfundimtare. 3. Seminari dorëzohet më së voni në orën e fundit të semestrit.		
Literatura primare:	- Brikena Kasmi: E drejta e medias, 2017, Albspirit -Monroe E. Price dhe Stefaan G. Verhulst: Routledge Handbook of Media Law, 2013, Routledge -Richard A.Posner: Frontiers of Legal Theory, Harvard University Press, 2004, Cambridge.		
Literatura shtesë:	Kushtetuta: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702 Ligj për Komisionin e Pavarur të Mediave: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2809 Kodi i Sjelljes për shërbimet mediale audioviele: https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1292592101.0176.pdf Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2503		

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>
 Ligji për mbrojtjen e burimeve në gazetari: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8864>
 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303>
 Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2503>
 Këshilli i Mediave të shkruara: http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Press-Code-for-Kosovo_alb.pdf
http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/vendim_KMSHK_1224-2022.pdf
 Ligji për të drejtat e autorit: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2787>
 Komisioni i Pavarur i Mediave (<https://www.kpm-ks.org/>)

Hartimi i planit mësimor

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezantim i syllabusit, diskutim për nocionet themelore të së drejtës së medias
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në raportin ligj–media: konceptet bazë
<i>Java e tretë:</i>	E drejta e privatësisë dhe interesit publik në media
<i>Java e katërt:</i>	E drejta e medias dhe mbrojtja e privatësisë
<i>Java e pestë:</i>	Burimet në gazetari dhe mbrojtja ligjore
<i>Java e gjashtë:</i>	E drejta për t’u harruar dhe arkivat digjitale të mediave
<i>Java e shtatë:</i>	Testi I
<i>Java e tetë:</i>	Raportimi nga gjykatat: e drejta për informim dhe gjykimi i drejtë
<i>Java e nëntë:</i>	Institucionet e drejtësisë dhe mbulimi medial: kufijtë ligjorë
<i>Java e dhjetë:</i>	Rregullimi ligjor i transmetuesit publik dhe politikat mediale në Kosovë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>Pronësia e medias dhe pluralizmi</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kornizat ligjore ndërkombëtare për lirinë e medias
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Mediat online, rrjetet sociale dhe kuadri ligjor kundër gjuhës së urrejtjes
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	E drejta e autorit përballë të drejtës së medias
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përsëritje, diskutim

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim.